



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.918/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada Glllogjani kryesuese, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Vjosa Isma kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.918/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Vjosa Isma, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, në Komunën e Rahovecit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet me nr. 1602X/01R, 1602X/02R, 1601A/03R, 1602A/01R.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.918/2021 të paraqitur nga Vjosa Isma, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, në Komunën e Rahovecit, me të cilën pretendon se në qendrat e votimit 1602X/01R, 1602X/02R, 1601A/03R, 1602A/01R, në FRK nuk shihen qartë numrat e votave të Kandidatëve, dhe kërkon nga PZAP që ta urdhëroj KQZ-në, ti rinumro fletvotimet e Kandidatëve për Kuvend Komunal në tërë Komunën e Rahovecit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Vjosa Isma, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, në Komunën e Rahovecit, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimin 1602X/01R, 1602X/02R, 1601A/03R, 1602A/01R, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e

supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.918/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesuese e Panelit**  
**Afijete Sada Gllgjani**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.